




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d), nenit 51, paragrafi 51.1 dhe nenit 52 të Ligjit nr. 03/L- 40, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), të dispozitave të neneve 3, 4, 5 dhe nenit 6, të Udhëzimit administrativ nr. 05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve të tjera në komunë, të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d) dhe të nenit 44, paragrafi 44.1, shkronja a) të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 05.01.2022, merr këtë

**VENDIM
PËR
FORMIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

I. Miratohet Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si komitet i përhershëm.

II. Komiteti për Politikë dhe Financa ka këtë përbërje:

1. Fehmi Kupina, kryesues;
2. Nora Kelmendi, LVV, anëtare;
3. Arbnora Berisha, LVV, anëtare;
4. Mirsad Vitia, LVV, anëtar;
5. Gëzim Sfeçla, LVV, anëtar;
6. Jeta Hasani - Rafuna, LDK, anëtare;
7. Donat Lushaku, LDK, anëtar;
8. Donjeta Dragusha, LDK, anëtare;
9. Shegë Beqiri - Badivuku, PDK, anëtare;
10. Plator Gërdovci, PDK, anëtar;
11. Bahri Gashi, AAK, anëtar.

III. Komiteti si në pikën I të këtij vendimi, është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, si dhe dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren

vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-020/01-3808/22, më 10.01.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

